



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Në mbështetje të Rregullores së MF-nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Thirrjen publike të MD-së, dt. 1.7.2024 si dhe Vendimin Nr. 18/2024, dt. 6.2.2024 të Sekretares së Përgjithshëm të MD-së për Themelimin e Komisionit Vlerësues për përzgjedhjen e projekteve për mbështetje financiare publike për OJQ-të e licencuara në fushën e shërbimeve sociale. Komisioni Vlerësues nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET**, Kërkesa e OJQ-ës sipas thirrjes publike të MD, dt. 1.7.2024 për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, si më poshtë:
 1. OJQ, Shtëpia e Sigurt, Gjakovë;
- II. **REFUZOHET**, Kërkesa e OJQ-së sipas thirrjes publike të MD, dt. 1.7.2024 për mbështetje financiare publike për projektet e OJQ-ve të licencuara në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare, si më poshtë:
 1. OJQ, Shoqata humanitare e prindërve me persona me aftësi të kufizuara mendore, Hadër - Prizren;

Arsyetim: OJQ, Shoqata humanitare e prindërve me persona me aftësi të kufizuara mendore, Hadër - Prizren, nuk ka ofruar dëshminë (certifikatën e licencës) ashtu siç është kërkuar në thirrjen publike të datës 1 korrik 2024 ku thuhet;

Organizatat jo-qeveritare e licencuara mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në ofrimin dhe avancimin e shërbimeve sociale përmes zbatimit të objektivave dhe aktiviteteve si më poshtë:

- Strehim dhe Shërbim për fëmijët pa kujdes prindëror, fëmijëve të abuzuar, keqtrajtuar dhe neglizhuar;

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: OJQ-të e pakënaqura me këtë Vendim mund të parashtrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave në MD, në afat prej 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij Vendimi në Ueb-faqen e MD-së.

Komisioni Vlerësues:

Skender Jahaj,

Illir Mazreku,

Fjolla Sojeva,

Fehmi Ibrahim

Almedine Jahaj

